



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 7651 Prot

Shkodër, më 17.05.2021

Lënda: Kërkesë për marrjen masave të menjëhershme për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të dëmtuara në rrugët e zonës historike, rrugë “Kolë Idromeno” dhe “G’juhadol”.

MINISTRISË SE KULTURES

DREJTORISË RAJONALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, SHKODER

Shumë nga objektet e trashëgimisë kulturore në zonën historike, në rrugët “Kolë Idromeno” dhe “G’juhadol” janë në gjendje të dëmtuar rëndë. Në Shkodër disa nga këto ndërtesa paraqesin gjithashtu një rrezikshmëri të lartë për qytetarët dhe kalimtarët.

Bazuar në ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar, projektet e mirëmbajtjes, të ruajtjes dhe restaurimit të pasurive kulturore materiale, hartohen nga institucionet e trashëgimisë kulturore, varësi e Ministrisë së Kulturës.

Referuar pikës 1 të nenit 83 të ligjit të sipër cituar, ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale, ndërhyrjet në sipërfaqet e dekoruara të pasurive kulturore materiale, si dhe çdo ndërhyrje për mirëmbajtjen e këtyre pasurive kryhen nga institucione shtetërore të specializuara.

Vërejmë që nga ana e Ministrisë së Kulturës, Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Shkodër, si dhe nga ana e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve nuk është marrë asnjë masë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, restaurimin dhe mirëmbajtjen objekteve të trashëgimisë kulturore në Shkodër të dëmtuara rëndë. Gjithashtu nuk është kryer asnjë inspektim për situatën, detyrim dhe përgjegjësi ligjore e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër.

Kur bëhet fjalë për marrjen e masave urgjente të sigurisë, sikurse ligji e përcakton, inspektorët e DRTK- Shkodër me vendim të ndërmjetëm, vendosin për pezullimin e çdo lloj veprimtarie mbi pasurinë kulturore, duke kërkuar ndërhyrjen e menjëhershme për restaurim dhe mirëmbajtje sipas ligjit.

Jemi në kushtet e dëmtimit të rëndë dhe të riparueshëm të objekteve ndërtesa, në dy rrugët “Kolë Idromeno” dhe G’juhadol”, situatë me rrezik edhe për jetën e banorëve e kalimtarëve, për shkak të mostrajtitimit të duhur, për shkak të mosveprimit për t’u mirëmbajtur.

Bashkia Shkodër kërkon marrjen e masave të menjëhershme, urgjente nga ana e Ministrisë së Kulturës, DRTK- Shkodër, dhe KKR-së për ruajtjen, riparimin dhe mirëmbajtjen e objekteve, ndërtesave në gjendje të rëndë infrastrukturore në rrugët historike “Kolë Idromeno”, “G’juhadol”, si dhe në çdo objekt tjetër që verifikohet me rrezikshmëri të lartë objekt i trashëgimisë kulturore. Siguria e qytetarëve dhe kalimtarëve në këto rrugë kërkon gjithashtu ndërhyrjen tuaj të menjëhershme.

Bashkia Shkodër shpreh disponibilitetin e saj, për bashkëpunim dhe bashkërendim, me qëllim sigurimin e ruajtjes dhe mbrojtjes së këtyre objekteve.

Shpresojmë që kjo kërkesë të vendoset në prioritetin e Ministrisë së Kulturës dhe të ndërhyhet në kushte të nevojës emergjente.

KRYETAR

Valtana Ademi

